REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

SEKTORI I TAKSAVE DHE TARIFAVE

Paketa Fiskale

Neni 28

Lehtësime dhe Përjashtime nga Taksat Vendore

- Për subjekte të reja të biznesit gjatë vitit nga gra, vajza dhe të rinj nën moshën 25 vjeç përfitojnë ulje të detyrimeve vendore në masën tridhjetë për qind (30%).

- Për territories ku nuk kryhet shërbimi, të specifikohet nga sektori përkatës dhe të mos aplikohet tarife pastrimi, ndriçimi apo gjelbërimi.

- Të gjithë emigrantët që kthehen nga emigracioni dhe hapin biznese të reja do të përjashtohen nga taksat dhe tarifat vendore për 3-vitet e para.

- Ulja në masën pesë për qind (5%) për çdo subjekt kur ai likujdon të gjitha detyrimet per taksat dhe tarifat vendore në një këst, brenda datës 20 Prill 2026.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- Banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga Bashkia si banesa sociale;
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë

- 8.Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- 9.Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.

Përjashtohen nga pagesa e taksës bujqësore:

- Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

- Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.